




Raport nga monitorimi i diskutimit parlamentar mbi ndryshimet e ligjit për arsimin e lartë



KUVENDI NËN THJERRËZ

**Përforcimi i debatit politik
dhe diskursit deliberativ**

Dhjetor 2014- Shkurt 2015



Përmbajtja e raportit

A. Hyrje	2
B. Përmbledhje.....	3
C. Metodologjia e hulumtimit	4
D. Konteksti politik	4
E. Zbulimet e bëra gjatë monitorimit.....	8
F. Argumentet kyçe në diskutimet për ndryshimet në Ligjin e Arsimit të Lartë	15
G. Përfundimi	21

A. HYRJE

Instituti për demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe Instituti për Evropën Lindore dhe Qendrore dhe Ballkanin (IELQB) duke filluar nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015 kanë monitoruar nivelin e cilësisë së debatit në Kuvend. Monitorimi bëhet në kuadër të projektit "Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe i diskursit deliberativ" financiarisht i përkrahur nga Bashkimi Evropian. Gjatë periudhës së monitorimit do të përgatiten dhjetë raporte mujore për cilësinë e debatit në Kuvend. Para jush është një raport i veçantë i cili i referohet vetëm diskutimit parlamentar për ndryshimet e Ligjit për Arsim të Lartë që u zhvillua në mes dhjetorit të vitit 2014 dhe shkurtit të vitit 2015. Propozimi për të ndryshuar ligjin ngjalli interesim të madh tek opinioni dhe ngjalli reagime tek opinioni akademik si dhe shkaktoi formimin e lëvizjes studentore që protestuan kundër ndryshimeve. Kjo lëvizje motivoi edhe organizimin e plenumëve në shkollat mesme, mësuesve dhe profesorëve. Ky raport përfshin një analizë të cilësisë së diskutimit për projekt-ligjin në Kuvend si dhe analize e argumenteve të paraqitura nga deputetët në lidhje me zgjidhjet e propozuara.

Me aplikimin e "Indeksit të cilësisë së debatit", sipas disa parametrave është vlerësuar çdo fjalim pjesëmarrësve të dy seancave plenare dhe dy seancat e Komisionit për Arsim dhe Shkencë në të cilin diskutuan për ndryshimet në Ligjin për Arsimin e Lartë.

Qëllimi i monitorimit është që në mënyrë empirike të arrihet deri në realizim se sa janë të argumentuara diskutimet në legjislaturë dhe se sa mirren parasysh qëndrimet e ndryshme dhe në çfarë mase ato kontribuojnë në përmbajtjen e ligjeve.



B.PËRBLEDHJE

Për ndryshimet e Ligjit për Arsimim të Lartë deputetët kanë debatuar gjerësisht dhe me argumente dhe shpesh diskutimet janë thelluar me replika dhe kontrareplika. Kjo prap nuk kontribuoi që ndonjë nga folësit të pranoj argumentet nga deputetë të tjerë dhe të ndryshon pozicionin e fillestar me të cilin hyri në seancë.

Deputetët gjatë sansave kanë paraqitur kryesisht argumente që arsyetonin pozicionet e tyre personale dhe ato partiake, dhe më pak në interpretim personal dhe analizë cilësore të argumenteve të paraqitura nga deputetë e opsioneve kundërshtare. Ajo tregon se deputetët janë shumë të rezervuar në lidhje me vlerat dhe cilësitë e argumenteve të të tjerëve, kjo mund të konsiderohet si një nga arsytet se pse asnjë deputet gjatë diskutimit nuk e ka ndryshuar qëndrimin e tij/saj fillestar.

Në shumicën e diskutimeve kemi identifikuar dy ose më shumë argumente, dhe gjatë gjithë seancës nuk është vërejtur asnjë diskutim pa asnjë shpjegim.

Më shumë se gjysma e diskutimeve ishin në formën e replikave dhe kontrareplikave të fjalimeve individuale të deputetëve.

Dhjetë deputetë nga opozita arritën pjesëmarrje prej 39% në diskutimet e përgjithshme.

Diskutime intensive rreth dispozitave të veçanta ligjore janë bërë kryesisht për shkak të deputeteve femra të cilat janë pjesë dominuese e numrit të përgjithshëm të diskutimeve të paraqitura në debatin mbi projekt-ligjin.

Gjatë arsytimit të qëndrimeve të tyre deputetët në 42% e diskutimeve kanë lidhur argumentet e tyre me të mirën e përgjithshme apo pasojat ose përfitimet për të gjithë qytetarët. Në 49% të rasteve folësit ishin neutral apo nuk i lidhnin qëndrimet e tyre me përfitime apo pasojat e ndonjë grupi në shoqëri.

Gjatë procedurës parlamentare për ndryshimin e Ligjit për Arsimin e Lartë nuk u mbajt diskutim publik i parashikuar me procedurat parlamentare.

Gjatë diskutimit deputetët u drejtuan drejt numrit të madh të ndryshimeve të propozuara për ligjin, por shkëmbim më intensiv të argumenteve ndodhi kur u diskutua me qëllimin kryesor të ndryshimeve të Ligjit për arsimin e lartë, rangimin e universiteteve dhe autonomia e tyre, aplikimi i provimit shtetëror, detyrimi i mësuesve të publikojnë punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare me faktor të ndikimit, mundësia që shtetas të huaj të huajve të zgjedhen dekanë dhe si dhe nëse janë dëgjuar pikëpamjet e të gjitha palëve të interesuara rreth ligjit.

C. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

"Indeksi i cilësisë së debatit", mundëson që çdo fjalim i mbajtur në seancat të kodohet sipas disa karakteristikave kryesore:

- Niveli i argumentimit;



- Niveli i respektimit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumenteve të tyre;
- Sinqeriteti të pranojë argumentet e të tjerëve dhe ndryshimi i pikëpamjeve të tyre nën forcën e argumenteve cilësore në debat;
- Nëse deputetët arsyetojnë në emër të interesave të kujt përfaqësojnë pikëpamjet e tyre;
- Nëse deputetët pa probleme mund të paraqesin pikëpamjet e tyre dhe
- Deri në çfarë mase është i pranishëm fjalimi i papërshtatshëm.

Në pjesën lidhur me analizën e argumenteve kyçe që folësit përdorin në diskutimin për Ligjin për arsimin e lartë janë shqyrtuar në procedurën e mëposhtme:

- Identifikimi dhe alokimi i të gjitha argumenteve në fjalimet e deputetëve në seancat plenare dhe mbledhjet e Komisionit për arsim dhe shkencë tek të cilat në rend të ditës ishte ndryshimi i Ligjit për Arsimin e Lartë.
- Grupimi i argumenteve sipas dispozitave ligjore që adresojnë.
- Evidentimi i numrit të argumenteve lidhur me të njëjtën dispozitë.
- Evidentimi se sa shpesh i njëjti argument është përsëritur në të njëjtën temë nga një ose më shumë folës.
- Grupimi i argumenteve sipas përmbajtjes së tyre Për dhe Kundër dispozitës që adresojnë.
- Ndarja dhe citimi i argumente kyçe që pasqyrojnë qëndrimin e përgjithshëm të folësve në aspektin e pozicionimit të tyre Për apo Kundër dispozitës që është temë e diskutimit.

D.KONTEKSTI POLITIK

Sipas Kushtetutës, Kuvendi ka autoritetin legjislativ dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Deputetët janë të zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta nga listat proporcionale zgjedhore për një mandat prej katër vitesh. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill të vitit 2014, partia Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) fitoi 61 deputetë, ndërsa partneri i tyre koalicionar, me të cilin ata kanë formuar qeverinë, Bashkimi Demokratik për Integrimin (BDI) fitoi 19 deputetë. Nga një vend në Kuvend fituan Opcioni qytetarëve për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK). Deputeti i cili morri mandatin nga RDK, pavarësisht vendimit të partisë për të bojkotuar Kuvendin, u bashkua me grupin parlamentar të BDI-së. Deri më tani grupi parlamentar i BDI-së ka 20 deputetë. Që nga zgjedhjet parlamentare në prill të vitit 2014 deri më 1 shtator, 2015 deputetët nga koalicioni kryesor opozitar të udhëhequr nga Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM), e cila në zgjedhje fitoi 34 mandate, bojkotojnë Kuvendin. Në muajin shkurt, në Kuvend kanë marrë pjesë vetëm dhjetë deputetët të opozitës, shtatë të Partisë Demokratike të Shqiptarëve (PDSH) dhe tre nga koalicioni opozitar i LSDM-së që vendosën të pranojnë mandatet.



Shumica në parlament në nëntortë vitit 2014 filloi procedurën për marrjen e mandateve të 31 deputetëve të opozitës të cilët bojkotojnë Parlamentin. Procedura ende nuk ka përfundua, që do të thotë që formalisht opozita mbajti mandatet edhe pse munguan nga puna e Kuvendit. Në fund të janarit, 2015, Zoran Zaev, lideri i opozitës e udhëhequr nga LSDM-ja opozitare filloi në konferenca për shtyp të publikojë të ashtuquajturat "bomba", dmth regjistrimet e përgjimeve audio të zyrtarëve të lartë shtetërorë.

Ndryshimi i Ligjit për Arsimin e Lartë

Propozimi për ndryshimin e Ligjit për Arsimin e Lartë ka ngjallur shumë interes tek opinionin nga momenti i shpalljes së tij deri në fund të debatit parlamentar në të cilin ligji u miratua në shkurt të vitit 2015.

Për synimin për të ndryshuar ligjin për herë të parë opinion u njoftua në tetor, 2014 nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës Abdilqim Ademi. Pjesë të propozimit si qëllimi për të futur provim shtetëror për studentët me të cilin Bordi për akreditim dhe vlerësim të arsimit të lartë, pavarësisht nga organet e universitetit do të testojë njohuritë e studentëve, shkaktoi reagime të ashpra. Studentët dhe profesorët e këtë e interpretuan si ndërhyrje në autonominë e universiteteve. Kjo çoi kryesisht për organizimin e studentëve në lëvizjen Plenumi Studentor që kundërshtoi publikisht përmbajtjen e reformave të shpallura.

Studentët në nëntor të vitit 2014 dolën në protestën e parë masive kundër përmbajtjes së reformave, protest i cili përfshinte mijëra njerëz. Zyrtarë të qeverisë komentuan se lëvizja studentore është e ndikuar nga partitë politike opozitare. Lëvizja studentore që nga fillimi u distanca nga ndikimet e partive politike, por haptazi pranoi se kërkesat e tyre janë politike. Procesi arriti kulmin me një protestë të dytë edhe më masive që u zhvillua në dhjetor si dhe në bazë të vlerësimeve nga mediat, në protestë morrën pjesë mbi 10 mijë njerëz. Ndërkaq, Ministri i Arsimit dhe Qeveria nuk pranuan takim të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e studentëve.

Në reagim ndaj propozimit për ndryshimin e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe lëvizjen në rritje të studentëve u formua dhe plenumi profesorëve, i cili përfshinte rreth 500 anëtarë të komunitetit akademik nga fakultete të ndryshme dhe institucioneve të arsimit të lartë në vend. Plenumi i profesorëve doli në krah me kërkesat e studentëve dhe plotësoi ato me analizë të detajuar të të metave të propozimit të qeverisë.

Në fund të dhjetorit kundër kërkesave të plenumeve për tërheqjen e plotë të propozim-ligjit u kriju një Iniciativa Civile, e cila kishte qëllim të mbështes diturinë në arsimin e lartë, e cila

Ministri i Arsimit Ademi njoftoi më 17 dhjetor se po atë ditë do të debatojnë me dekanët e fakulteteve rreth reformave në hapësirat e Fakultetit Pedagogjik. Megjithatë, në momentin e fundit debati u zhvendos në Ministri për shkak se, siç tha ministri "ekzistonte mundësi që studentët të ndërhyjnë në diskutim." Takimi me dekanët u mbajt me dyer të mbyllura, ndërsa një grup studentësh protestuan përpara ministrisë.

Qeverisë në senancë më 22 dhjetor dërgoi projekt-ligjin në procedurë parlamentare dhe kërkoi institucionet e arsimit të lartë të deklarohen për atë. Plenumet komentuan se afati i dhënë që universitetet të japin mendim është shumë i shkurtër dhe se është jashtë procedurës së dëgjimeve



publike, të cilat duhej organizuar në fazat e më hershme të miratimit të propozimit, e jo kur ajo tashmë është dërguar në Parlament.

Studentët dhe profesorët kërkuan zyrtarisht të marrin pjesë dhe të diskutojnë në seancën e Komisionit për Arsim planifikuar për 26 dhjetor në shqyrtimin e parë të propozim-ligjit të kontestuar. Parlamenti nuk u deklarua zyrtarisht për kërkesën për pjesëmarrje në seancën e Komisionit, i cili më 26 dhjetor miratoi ligjin, ndërsastudentët dhe profesorët protestuan jashtë ndërtesës së parlamentit.

Më 28 dhjetor, disa qindra profesorë nënshkruan një letër të hapur duke u bërë thirrje deputetëve që të refuzojnë amendamentet.

Pas festive të Vitit të Ri, kryeministri Nikolla Gruevski ftoi në diskutim komunitetin akademik në lidhje me amendamentet e propozuara e cila do të mbahej më 5 janar në hotelin Alexander Palace në Shkup. Anëtarët e plenumit të profesorëve para diskutimit refuzuan të marrin pjesë për arsye se ata konsideruan që nuk është në procedurat legislative për dëgjime publike dhe një hotel nuk është vend i përshtatshëm për një diskutim të tillë.

Përderisa përfaqësuesit e Plenumit të profesorëve deklaroheshin për mediat kryeministri personalisht ndërhyri me propozim për të mbajtur diskutimin në Kuvend disa orë më vonë. Anëtarët e Plenumit në fillim pranuan, por më vonë Plenum i profesorëve dolën me qëndrim të përbashkët se diskutimi nuk do të jetë pjesë e procedurave për miratimin e amendamenteve dhe se vendimi personal i Kryeministrit për të lëvizur diskutimin në parlament cenon ndarjen kushtetuese të pushteteve në shtet ose një ndërhyrje të ekzekutivit në punën e legjislativit.

Diskusimi në Parlament u mbajt gjithsesi. Në të morën pjesë profesorë nga Iniciativa Civile për të mbështetur diturin në arsimin e lartë dhe rektori i universitetit më të madh shtetëror Shën Kirili dhe Metodi, Velimir Stojkovski, kryeministri dhe disa ministra. Në diskutim nuk morën pjesë përfaqësues të Plenumit të profesorëve, ndërsa anëtarët e plenumit studentor nuk ishin të ftuar.

Më 9 janar Komisioni Parlamentar për Arsim miratoi ligjin në leximin e dytë, pas së cilës më 14 janar me shumicë parlamentare u miratua projekt-ligji edhe në seancë plenare.

Presidenti Gjorge Ivanov nënshkroi ndryshimet e Ligjit për Arsimin e Lartë më 22 janar me çka ai erdhi në fuqi. Megjithatë, pavarësisht se ligji u bë i vlefshëm më 30 janar Senati i Universiteti të Shën Kirilit dhe Metodit kërkoi nga Ministria sa më shpejt të organizoj një diskutim me profesorët, studentët dhe të gjithë palët e interesuara në procesin e arsimit të lartë që do të lindin propozimin për ndryshime apo ligjin e ri për arsim të lartë. Ministria më 2 shkurt pranoi të ketë diskutim me përfaqësuesit e Universitetit.

Kryeministri Gruevski dhe disa ministra më 6 shkurt ftuan dhe u takuan me përfaqësues të rektoratit, dhe plumeve të profesorëve dhe studentëve. Në këtë takim u ra dakord të shtyhet zbatimi i Ligjit të miratuar për Arsimin e Lartë, ose të shtyhet zbatimi i dispozitave më të diskutueshme të ligjit.

Parlamenti më 10 shkurt miratoi shtyrjen e zbatimit të ligjit.



Megjithatë, studentët në përgjigje të miratimit të ligjit dhe përjashtimin e tyre nga debati me 11 shkurt uzurpuan nërtesën e fakultetit Filozofik dhe Filologjik në kampusin e Shën. Kirilit dhe Metodit në Shkup dhe deklaruan zonë autonome. Ligjeratat e rregullta në shumicën e fakulteteve u ndaluan, nërsa profesorët dhe studentët në zonën autonome organizuan ligjërata alternative. Studentët më 12 shkurt shpallën zonë autonome edhe në fakultetin e inxhinierisë mekanike ku u bashkuan studentët e univerziteteve teknike. Këto ditë zona të ngjashme u deklaruan në disa fakultete të tjera. Studentët dhe profesorët bënë thirrje për tërheqjen e ligjit dhe ngritjen e grupeve punuese në të cilat edhe ata do të ishin pjesëmarrës si dhe për përgatitjen e një ligji të ri për arsimin e lartë.

Më 19 shkurt u mbajtën bisedime në mes të përfaqësuesve universitarë si dhe plenumëve të profesorëve dhe studentëve dhe përfaqësues të qeverisë në hapsirat e rektoratit të universitetit Shën Kirili dhe Metodi. Pas bisedimeve disa orëshe zyrtarë të qeverisë pranuan të formojnë grupe pune që do të përfshijnë studentët dhe profesorët të cilët do të punojnë në një ligj tërësisht të ri për arsimin e lartë. Studentët më pas deklaruan mbylljen e zonave autonome nëpër fakultete.


E.ZBULIMET E BËRA GJATË MONITORIMIT

Ky raport mbulon debatin në Parlament mbi propozimin e ndryshimeve të Ligjit për Arsimin e Lartë, të cilat u diskutuan në 5 seanca parlamentare të mbajtura në dhjetor të vitit 2014, dhe janar dhe shkurt të vitit 2015. Janë analizuar 83 fjalime të pjesëmarrësive në diskutimet e 3 seancave plenare dhe 2 të Komisionit për Arsim dhe Shkencë.

Nga numri i përgjithshëm i fjalimeve të monitoruara, nga 80 janë deputetë të Kuvendit dhe 3 janë nga pjesëmarrës të jashtëm si ministri i Arsimit dhe Shkencës Abdilaqim Ademi dhe Zëvendës Ministri Spiro Ristovski. Ky raport ka të bëjë vetëm me fjalimet e deputetëve.

Në lidhje me karakteristikat demografike të deputetëve:


- Gjinia: 64% femra dhe 36% meshkuj.
- Përkatësia etnike: 81% janë maqedonas etnikë, 19% shqiptarë etnikë.
- Arsimiti: 29% kanë arsim të lartë, 36% Master, 35% doktorë shkencash.
- Në diskutimet për ndryshimet e Ligjit për Arsim të Lartë në seancat e vëzhguara më aktiv ishin deputetët e njësis së parë votuese, ndërsa më pak diskutime kishin deputetët e njësis së gjashtë votuese.



Deputetët e opozitës (10) në diskutimet mbi ndryshimet e propozuara për Ligjin e Arsimit të Lartë kishin pjesëmarrje të konsiderueshme edhe pse janë vetëm 12% të numrit të përgjithshëm të deputetëve në Kuvend në këtë moment. Kur diskutohej për Lihjin për Arsim të Lartë, opozita arriti të jetë 39% pjesë e diskutime të përgjithshme.




Në diskutimet e pesë seancave mbi ndryshimet në e Ligjit për Arsimin e Lartë, grate të cilat përbëjnë 35% të përbërjes aktuale të Kuvendit ishin shumë më aktive se meshkujt. Deputeteve u përkasin 64% të të gjitha diskutimeve të prezentuara për këtë pikë të rendit të ditës, ndërsa meshkujve 36%.






Diskutimet mbi ndryshimet për Ligjin e Arsimit të Lartë në të gjitha seancat së bashku zgjati gjithsej 6 orë dhe 27 minuta. Brenda kësaj kohe, deputetet folën për 4 orë dhe 15 minuta, ndërsa deputetët 2 orë dhe 12 minuta. Mesatarisht çdo diskutim i deputeteve zgjati rreth 5 minuta, ndërsa deputetëve meshkuj rreth 4 minuta.



Sipas pjesmarrjes, nëse koha e përgjithshme e diskutimeve të monitoruar ndahet me numrin e përgjithshëm të mandateve të miratuara nga deputetët, vijmë në përfundim se mesatarisht çdo deputet nga shumica (82 vende) ka folur 2.5 minuta, ndërsa çdo deputet i opozitës (10 deputet) nga 17 minuta. Ndërsa nëse koha e përgjithshme e diskutimeve ndahet vetëm me deputetët që morën fjalën në seancat e monitoruara, duket se çdo fjalim i paraqitur nga deputetët e opozitës zgjati mesatarisht 5 minuta, ndërsa fjalimet e deputetëve të shumicës mesatarisht prej 4 minuta.

I. Llojet e fjalimeve dhe ndërveprimi

Monitorimi i diskutimit në Kuvend në lidhje me përmbajtjen e propozimit për të ndryshuar na Ligjin për arsimin e lartë tregon se deputetët më së shpeshti hyjnë në diskutime kur krahasohet me ndryshimet e tjera për të cilat debatohej në të njëjtën periudhë, dhe që gjithashtu kishin interes të madh publik. Për shembull, në janar Kuvendi diskutoi ndryshimet në Kushtetutë me vetëm 8% e diskutimeve ishin replika, dhe 11% kontrareplika. Në diskutimin mbi Ligjin për Arsimin e Lartë nga numri i përgjithshëm i diskutimeve 47% ishin fjalime, dhe 53% ishin përgjigje e argumenteve të parashtruara nga nga deputetët në fjalime, gjegjësisht 29% replika dhe 24% kontrareplika.



Në veçanti, kur diskutohej për ndryshimet në Ligjin për Arsimin e Lartë deputetet paraqiteshin për fjalë pothuajse dy herë më shumë në krahasim me meshkujt. Të dhënat nga diskutimet e monitoruara tregojnë



se gratë dhanë 58% të fjalimeve personale, 65% të replikave dhe 74% të kontrareplikave. Deputetët meshkuj dhanë 42% të fjalimeve personale, 35% të replikave dhe 26% të kontrareplikave.

II. Shkalla e argumentimit të fjalimit

Nga monitorimi i fjalimeve sipas Indeksit të cilësisë së debatit, në diskutimet rreth ndryshimeve të Ligjit për arsimin e lartë në 88% të rasteve mbrojtën qëndrimet e tyre me argumente. Në 49% të rasteve me dy ose më shumë argumente, dhe në 39% me një argument. Në 12% të diskutimeve nuk është gjetur argument i plotë. Gjatë monitorimit të diskutimeve për Ligjin për arsimin e lartë nuk janë vërejtur diskutime ku nuk është paraqitur asnjë argument.




Sipas të dhënave vërehet se sa më shumë që folësit thellohen në diskutim aq më shumë zvogëlohet numri i argumenteve të përdorura për të shpjeguar dhe justifikuar qëndrimet e tyre. Prandaj, folësit në debatin mbi ndryshimet në Ligjin e Arsimit të Lartë kishin argumente më të qëndrueshme gjatë fjalimeve personale. Prandaj, 69% të diskutimeve në të cilat ka më shumë se dy ose më shumë argumente ishin fjalime individuale. Në 26% të replikave janë vendosur dy ose më shumë argumente dhe vetëm në 5% të kontrareplikave.

Një argument është përdorur në 26% të fjalimeve, 35% të replikave, dhe 39% të kontrareplikave. Shpjegim i dobët në të cilin nuk është identifikuar të paktën një argument i plotë është vërejtur në 30% të fjalimeve, 20% të replikave dhe në mbi 50% të kontrareplikave.

Mund të vërehet se sa më shumë është thelluar diskutimi me replica dhe kontrareplika deputetët dështojnë për të ruajtur nivelin e argumentimit siç është rasti tek fjalimet. Megjithatë, kjo është pjesërisht




e justifikuar duke pasur parasysh se koha e lejuar sipas Rregullores për replika dhe kontrareplika është më e shkurtër se tek fjalimet.




Duke pasur parasysh se gratë deputete ishin aktive gjatë të gjitha seancave për të diskutuar Ligjin për Arsimin e Lartë atyre ju takojnë shumica e argumenteve të përdorura në fjalime. Pra, deputetet në 34% të diskutimeve të përgjithshme kanë përdorur dy ose më shumë argumente, dhe deputetët vetëm në 15%. Gratë në 23% të diskutimeve të kanë mbështetur pozicionet e tyre me nga një argument, dhe meshkujt në 16% të diskutimeve. Në 7% të diskutimeve të grave arsyetimi është i dobët apo i



pamjaftueshëm për t'u konsideruar si argument i plotë. Burrat kishin "arsyetim të dobët" në 5% të diskutimeve.



Nëse analizohet shkallë shpjegimit sipas opsionit politik të cilit i përkasin folësit, duket se deputetët e shumicës dhe opozitës kishin përqindje pothuajse të barabartë të diskutimeve ku përdoren dy ose më shumë argumente. Deputetët nga shumica llogariten për më shumë diskutime në të cilat është përdorur një argument, por llogariten për më shumë edhe tek diskutimet në të cilat shpjegimi është vlerësuar si "i dobët."




III. Fuqia e një argumenti të mirë

Në monitorimin e diskutimeve mbi ndryshimet në Ligjin e Arsimit të Lartë ngjashëm me raportet e monitorimeve të mëparshme të seancave të tjera parlamentare asnjë deputet nuk ka ndryshuar qëndrimin e tij/saj i/e ndikuar nga argumentet më të mira të folësve të tjerë. Gjatë diskutimeve mbi



ndryshimet në Ligjin e Arsimit të Lartë në 51% të rasteve folësit nuk njohin vlerën e argumenteve të pjesëmarrësve të tjerë në diskutim dhe nuk ndryshojnë qëndrimin e saj. Në 36% të rasteve gjithashtu nuk e kanë ndryshuar qëndrimin, por kanë njohur vlerën e argumenteve të folësve të tjerë. Ky vlerësim tregon se shumica e folësve kishin pozicion të njëjtë me pjesëmarrësit e tjerë në diskutim dhe shprehin respekt për argumentet e tyre dhe se një pjesë tjetër e folësit kishin qëndrime të ndryshme, por shprehin respekt dhe njohin vlerën e argumenteve të bashkëbiseduesit. Megjithatë, pranimi dhe njohja e vlerës së argumenteve të të tjerëve në asnjë rast nuk çoi deri tek ndryshimi i qëndrimeve tek folësit.




IV. Respekt ndaj bashkëfolësit

Në diskutimet mbi ndryshimet në Ligjin e Arsimit të Lartë deputetët kryesisht shprehën respekt ndaj pjesëmarrësve të tjerë në séance, kjo është vërejtur në 42% të rasteve. Në 30% të rasteve folësit nuk kanë shprehur ndonjë lidhje me pjesëmarrësit e tjerë, dhe 21% kanë shprehur respekt të pjesshëm. Respekti i pjesshëm do të thotë folësit në shumicën e diskutimeve të tyre ishin neutrale ose tregojnë respekt për




pjesëmarrësit e tjerë, por në një masë më të vogël nxituan sulme partiake ose personale mbi pjesëmarrësit e tjerë.



V. Respektimi i argumenteve

Në kushtet e respektimit të argumenteve të folësve të tjerë, kur deputetët diskutuan ndryshimet në Ligjin e Arsimit të Lartë në shumicën e rasteve 51% shprehën respektin e tyre. Në 22% të rasteve nuk ka shprehur ndonjë mendim për argumentet e folësve të tjerë dhe gjithashtu në 22% të rasteve kanë shprehur pajtueshmëri të pjesshëme. Në 1% të diskutimeve, folësit shprehën pjesërisht përbuzje ndaj argumenteve të folësve të tjerë. Mos respektim i pjesshëm do të thotë se shumica e folësve shprehën në diskutimet e tyre sulme partiake ose personale, dhe më pak ishin neutral.




VI. Përfshirja e shpjegimit dhe ndërprerja

Kur deputetët diskutuan ndryshimet në Ligjin për Arsimin e Lartë në shumicën e rasteve, apo 49% ishin neutral dhe nuk lidhen argumentet e tyre me përfitimet ose pasojat e ndonjë grupi etnik, fetar, social apo parti politike. Në 42% të diskutimeve deputetëve lidhen argumentet e tyre me përfitimet ose pasojat për të mirën e të gjithë qytetarëve. Në 5% të diskutimeve, folësit lidhen argumentet e tyre me përfitime ose



pasojat për grupe të tjera përkatësisht grupeve të ndryshme sociale dhe profesionale në shoqëri dhe 4% për përfitime apo pasoja për grupet e tyre etnike, politike ose grupeve sociale.



VII. Fjalim i papërshtatshëm

Në lidhje me fjalimin e papërshtatshëm, pjesëmarrësit në debatet e monitoruara parlamentare në këtë periudhë në përgjithësi janë përmbajtur nga përdorimi i tij. Gjithashtu në seancat në të cilat diskutohet për ndryshimet e Ligjit për Arsimin e Lartë nuk u vërejtën raste të kufizimit të deputetëve në fjalimet e tyre.

F. ARGUMENTET KYÇE NË DISKUTIMIN PËR NDRYSHIME NË LIGJIN PËR ARSIMIN E LARTË

Propozimi për ndryshime në Ligjin për Arsimin e Lartë të cilin diskutuan deputetët parashikon ndryshime më të gjera në sistemin arsimor. Deputetët duke u bazuar në disa prej tyre argumentuan për dhe kundër ndryshimeve të propozuara. Në diskutim deputetët e opozitës të cilët ishin deputet të pavarur të cilët vijnë nga koalicioni opozitar zgjedhor i LSDM-së dhe shtatë deputetë të PDSH –së kundërshtuan pjesën më të madhe të ndryshimeve. Deputetët nga shumica e koalicionit të VMRO-DPMNE-së dhe BDI -sënë përgjithësi mbështetën ndryshimet me përjashtim të disa anëtarë të partive të vogla si DOM. DS dhe GROM që janë pjesë e shumicës në pushtet, por që për çështje të caktuara morën një pozicion neutral, dhe rreth disa ndryshimeve të propozuara edhe kundërshtuan . Bazuar në argumentet e paraqitura nga



folësit në komision dhe seanca plenare parlamentare mund të konkludohet se deputetët shpesh janë fokusuar në këto gjashtë tema që lidhen me ligjin:

- Qëllimi i ndryshimeve në Ligjin për Arsimin e Lartë
- Renditja e universiteteve dhe autonomia e tyre
- Aplikimi i një provimi shtetëror
- Revista me faktor impakti
- Shtetasit e huaj mund të jenë dekanë
- Debati publik mbi ndryshimet në Ligjin për Arsimin e Lartë

Qëllimi i ndryshimeve në Ligjin për Arsimin e Lartë

Sa i përket temës së parë, deputetët diskutuan se çka është qëllimi i përgjithshëm i ndryshimeve të ligjit dhe se si ajo do të përmirësojë arsimin e lartë dhe a do të ndërhyj në sistemin e Bolonjës.

Deputetët e opozitës e kundërshtuan ndryshimet duke pohuar se para propozimit nuk është bërë analizë e bazuar në të dhëna të gjendjes aktuale në të gjithë sistemin arsimor, duke përfshirë arsimin e lartë, as edhe vlerësim dhe strategji për zhvillimin e arsimit dhe drejtimim që do të lëvizë reforma. Opozita kundërshtuan përputhshmërinë e reformave me sistemin e Bolonjës në arsimin e lartë.

Solza Grçeva deputete e pavarur, Komisioni për Arsim dhe Shkencë, seanca nr. 14, leximi i dytë, 9 janar, 2015:

"Sistemi i Bolonjës nuk ekziston më. Ky proces nuk lejon të testohet studenti pas vitit të dytë "... Keni futur studime të detyrueshme 4 vjeçare (deri-diplomike) me 2 vjet (post-diplomike). Me numrin e kredive bëhemi të papërputhshëm me gjithë botën e jashtme. Evropa nëpërmjet (deri-diplomike) programin Horizon 20/20 parashikon të holla të mëdha që studentët tanë nuk do të jenë në gjendje ti përdorin."

Pavle Trajanov, DS, Seanca Plenare nr. 31 leximi i dytë, 14/01/2015:

"Ne tani flasim për reformat, të gjitha flasim se janë të nevojshme, por me të vërtetë na mungon një analizë e thellë, më e gjatë në bazë të asaj që ne ndryshojmë, ne nuk kemi një strategji se në cilin drejtim do të lëvizin këto reforma dhe çfarë efekte do të shkaktojnë"



Deputetët nga shumica nuk kontestuan këto pretendime me kontrarelik, por theksuan nevojën për ndryshimet e propozuara në ligjin që të diplomuarit e ardhshëm të jenë më të përshtatshëm për nevojat e tregut të punës.

Spresa Hadri, BDI, Komisioni për Arsim dhe Shkencë, takim nr. 13 leximi i parë, 26 dhjetor, 2014:

"Qëllimi i studentëve është të diplomojnë dhe të gjejnë punë, edhe pse jo të mitur, por jo ende mjaft të rritur që të jenë të vetëdijshëm se fakulteti nuk mbarohet vetëm për diplomën, por për njohuri. Ka prodhim të tepërt të diplomave dhe ka problem të madh me të rinjtë e diplomuar."

Renditja e universiteteve dhe autonomia e tyre

Deputetët e opozitës kundërshtuan ndryshimet, dhe më së shumti shpalljen e renditjes së universiteteve duke pohuar se ato janë baza për vendosjen e kontrollit të drejtpërdrejtë të ekzekutivit në institucionet e arsimit të lartë dhe shkelja mbi autonominë e tyre në vendimmarrje dhe veprimtari që është e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës së shtetit. Ata besojnë se shumica e dispozitave të ligjit përbëjnë ndërhyrje të Ministrisë së Arsimit, dhe nëpërmjettë saj edhe e qeverisë në mënyrën e mësimdhënies, hulumtimit, ligjerimit dhe testimeve. Opozita kundërshtoi me forcë dispozitat që parashikojnë dënime për dekanët e fakulteteve me të cilat është e mundur të gjobiten më 10 deri në 30 mijë euro për institucionet e arsimit të lartë dhe dënime me burgim për dekanët.

Solza Grçeva, deputete e pavarur, Komisioni për Arsim dhe Shkencë, Takim nr. 13, leximi i parë, 26 dhjetor, 2014:

"Ndalimi i studimeve të doktoratës në të gjitha, pos 5 universiteteve të ranguar sipas kriterve që nuk ekzistojnë, kjo shkel autonominë e universiteteve e garantuar me kushtetutë dhe lirinë e tyre akademike."

Deputetët nga shumica nuk dhanë hollësi mbi akuzat për shkeljen e autonomisë universitare, por janë argumentuar se është i nevojshëm rangimii universitetet çdo dy vjet, dhe profesorët që kualifikohen për



mentor gjatë studimeve të doktoraturës nuk do të ndikohen nëse universitetet e tyre nuk do të marrin të drejtën për të organizuar studimet e doktoraturës.

Mirvan Xhemajli, BDI, Komisioni për Arsim dhe Shkencë, takim nr. 13, leximi i parë, 26 dhjetor, 2014:

"Nëse një nga universitetet renditet në top 5 universitetet më të mira, automatikisht mund të organizojë studime të doktoraturës, por përsëri duhet të përmbushë kushte shtesë si akreditimi i mentorëve, kushtet hapësinore dhe me këtë procedurë nuk iu është marrë mundësia profesorëve të cilët nuk janë të punësuar në këto pesë universitete të lartë-renditura, ata mund të akreditohen për mentor të studentëve në ciklin e tretë dhe të jenë në gjendje që të angazhohen në studimet e ciklit të tretë në universitetet e akredituara për ato. Pra, nëse një universitet nuk është renditur në top 5, por ka ndonjë profesor i cili i plotëson kushtet dhe është/ e akredituar nga Bordi i Akreditimit si mentor, i njëjti mund të angazhohen në ciklin e tretë, të ligjerojë dhe të jetë mentor në universitetet që janë ranguar më lartë. "

Aplikimi i një provimi shtetëror

Diskutimi më i madh ka evoluar rreth një dispozite në ligjin që paraqet provim shtetëror të detyrueshëm për studentët në vitin e dytë të studimeve që do të zbatohet nga Bordi i akreditimit dhe vlerësimit të arsimit përbërja e sëcilës zgjidhet nga Parlamenti. Deputetët nga shumica arsyetuan argumentet e tyre me atë se provimi nuk do të ndikojë në vlerësimet e studentëve, por do të jetë një vlerësim i cilësisë së arsimit të lartë dhe njohuritë e studentëve me çka do vlersohetse sa studentët si qytetar të ardhshëm me arsim të lartë janë të përgatitur profesionalisht për punë. Ata thonë se është më mirë provimi të përbëhet nga dy pjesë me shkrim dhe me gojë.

Mirvan Xhemajli, BDI, Komisioni për Arsim dhe Shkencë, Mbledhja nr. 13, leximi i parë, 26 dhjetor, 2014:

"Provimi shtetëror -Provimi do ta organizojë bordi i evaluimit, ndërsa ministria dhe qeveria nuk kanë asnjë rol në organizimin e provimit, ndërsa qëllimi i verifikimit të OECD-së është një mënyrë për të matur cilësinë e studentëve që vijnë nga vendet jashtë OECD-së."



Olga Najdenovska, VMRO-DPMNE, Komisioni për Arsim dhe Shkencë, seanca nr. 13, leximi i parë, 26 dhjetor, 2014:

"Qeveria ka për qëllim ta përmisojë cilësinë e arsimit të lartë me provimin shtetëror, me të cilin qeveria, ne si profesor dhe prindërit dhe i gjithë shteti do ta përdorim për tu siguruar që studentët kanë njohuri praktike, aftësi të cilat më vonë mund ti aplikojnë si staf me arsim të lartë i dalë nga fakultetet, për të siguruar cilësinë e kualifikimeve të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë."

Aleksandar Nikollovski, VMRO-DPMNE, seanca plenare nr. 31, leximi i dytë, 14/01/2015:

"Për shkak se dita që do të dalin nga fakulteti gjëja e parë që ju duhet është njohuri në kompanitë private, ndërsa me reformat e ligjeve në administratën publike të cilat ky Parlament i votoi në edhe në administratën publike numër një është dituria, pastaj vjen çdo gjë tjetër. Nëse është kështu, kontrolli i jashtëm në llojin e provimit shtetëror është mekanizëm jashtëzakonisht i mirë për të parë se ku jemi dhe të shohim nëse ato profesorë janë duke edukuar si duhet këta studentë. "

Deputetët e opozitës besojnë se nuk ka nevojë për të futur një provim shtetëror. Diskutimi i nxitur nga dispozitat që parashohin që provimi të organizohet nga Bordi i Akreditimit dhe Evaluimit. Deputetët e opozitës besojnë se futja e provimit është ndërhyrje në autonominë e universiteteve dhe shprehjes së mosbesimit ndaj institucioneve të arsimit të lartë. Ata kundërshtuan edhe dispozitën e prezantuar për provim shtetëror për studentët të cilët kanë diplomuar në shtetet e tjera për aq kohë sa dëshirojnë të bëjnë nostrifikimin e diplomës në vend.

Solza Grçeva, deputete e pavarur, Komisioni për Arsim dhe Shkencë, seanca nr. 13, leximi i parë, 26 dhjetor, 2014:

"Ai që akreditonë nuk duhet vlerësuar, ndërsa ju i bashkuat ato në një, Komisioni për akreditim dhe vlersim. Por ju lutem na thuani se pse ai nuk ka kryer vlerësim të rregullt të jashtëm të universiteteve për çdo vit? ... Si mendoni ju tani të vlersoni vetëm me një dimension, qoftë i kaluar apo jo kaluar provimi shtetëror a kemi arsim cilësor? "



Ljubica Buralieva, deputete e pavarur, Komisioni për Arsim dhe Shkencë, seanca nr. 14 leximi i dytë, 9 janar, 2015:

"Absolutisht nuk ka nevojë të egziston një zgjidhje si provimi shtetror, unë sugjeroj një tjetër qasje, pajtohem se duhet të ketë një sistem për kontrollin e njohurive të studentëve aty ku inspektimet gjejnë deformime dhe mangësi. Të kenë mundësi të bëhet testim i njohurive dhe në qoftë se studentët tregojnë rezultate të dobëta të kenë mundësi për orë shtesë dhe të dalin përsëri para profesorëve nga universitete të tjera. Ne mund të organizojmë ekzaminim të tillë pa cenuar autonominë e universitetit dhe ajo të mos jetë ndëshkim. "

Liljana Popovska, DOM, Seanca Plenare nr. 31, leximi i dytë, 14/01/2015:

"Unë mendoj se ky provim shtetror i propozuar nuk do të përmirësojë cilësinë dhe do të jetë barrë për studentët dhe në shpinat e tyre do të thyhen të gjitha të metat nga arsimi fillor deri tek arsimi i lartë."

Revista me faktor impakti

Deputetët e opozitës dhe deputetja e Dom, Liljana Popovska, i cili në atë kohë ishte pjesë e shumicës udhëheqëse i kundërshtuan ndryshimet në Ligjin për Arsimin e Lartë me çka profesorët universitar janë të obliguar që të publikojnë punime në gazetatat shkencore me reputacion ndërkombëtar për të përparuar në nivelet akademike.

Solza Grçeva, deputete e pavarur, Komisioni për Arsim dhe Shkencë, seanca nr. 14 leximi i dytë, 9 janar, 2015:

"Revista me faktor të ndikimit nuk janë të zbatueshme për të gjitha shkencat, profesorë të gjuhës maqedonase nuk mund të publikojnë në revista të tilla, dhe keni harruar krejtësisht i ata të etnologjisë dhe antropologjisë me kriteret e përjashtimit. Përparimi i shkencës nuk është i mbështetur financiarisht, nuk ka pjesëmarrje në konferenca të huaja shkencore dhe abonimet në revista profesionale të cilat janë veçanërisht të rëndësishme për shkencën. "



Liljana Popovska, DOM, Seanca Plenare nr. 31, leximi i dytë, 14/01/2015:

"Çështja e tretë që është trajtuar në ndryshimet të cilat nuk janë marrë parasysh është çështja e barazimit të kushteve për botim në gazeta shkencore sin ë ato humane dhe sociale me ato të shkencave natyrore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme përsëri për shkencat humane dhe sociale të cilët janë në disavantazh nga shkenca për disa arsye: pak revista me faktor ndikimi, faktor ndikimi më i ulët, më pak gjasa për të publikuar autorët tanë, sepse arsye kombëtare dhe rajonale si dhe mënyra e pagesës , dhe se shkencat humane dhe sociale janë tërësisht të rëndësishme për mbijetesën dhe zhvillimin e shtetit dhe kombit maqedonas, por duke pasur parasysh aspektet historike dhe gjeopolitike përmbajtje të tillë është jashtëzakonisht e vështirë të depërtojnë në revista dhe publikime ndërkombëtare. "

Deputetët e shumicës nuk diskutuan për këtë çështje.

Shtetasit e huaj mund të jenë dekanë

Deputetja, Liliana Popovska, DOM e zhvilloi diskutimin në lidhje me dhënien e propozimit për të ndryshuar Aktin e Arsimit të Lartë i cili ofron për shtetasit e huaj që të jenë dekanë të institucioneve të arsimit të lartë në vend. Problematike ishte për deputeten ishte mundësia e punësimit të personave nga vendet fqinje dhe gjuha me të cilën ata do të punojnë.

Liljana Popovska, Komisioni për Arsim dhe Shkencës, seanaca nr. 14 leximi i dytë, 9 janar, 2015:

"Ne kemi nevojë për të ruajtur institucionet e arsimit të lartë, ato duhet qeverisur nga qytetarët tanë, si institucione të ndjeshme për shkak se këtu janë të formohen, përvetësohen njohuri dhe ideologji. Për këtë kishin vërejtje të gjitha fakultetet përveç provimit shtetëror. "



Ndoshta kjo ishte e vetmja dispozitë për të cilën deputetët e opozitës VMRO-DPMNE dhe deputetët të pavarur ranë dakord dhepatën të njëjtin qëndrim, dhe që ishin në kundërshtim me deputetën e DOM.

Ilija Dimovski, VMRO-DPMNE, Komisioni për Arsim dhe Shkencë, séance nr. 1, leximi i dytë, 9 janar, 2015:

"Unë kam besim në profesorët dhe anëtarët e këshillave shkencor se nuk mundësi teorike për të bërë këtë, dhe kjo do të mohonte aftësitë e fakulteteve teknike për të hapur mundësi për të prezantuar konkurrencë të vogël me përvojë ndërkombëtare."

Solza Grçeva, deputete e pavarur, Komisioni për Arsim dhe Shkencë, seanca nr. 14 leximi i dytë, 9 janar, 2015:

"Në Europë ka raste ku universitetet janë të detyruar në konkurrencë ndërkombëtare. Tek shumë fakultete tek kandidatët kërkohet portfolio shkencor dhe kjo sjell cilësi më të lartë për institucionin, pavarësisht nga origjina e kandidatit. Kur në UEJL kishte ekspertë të huaj, institucioni kishte cilësi më të lartë. "

Zoran Ilioski, VMRO-DPMNE, seanca plenare nr. 31 leximi i dytë, 14/01/2015:

"Unë do të doja të theksoj se mundësia e shtetasve të huaj për të aplikuar të jenë rektorë të universiteteve tona është në mënyrë për ta rritur konkurrencën dhe në këtë mënyrë jepet mundësia që kuadër cilësor të jenë liderë, dmth të udhëheqin fakultetin në qoftë se Këshilli Akademik i atij fakulteti vlerëson se janë adekuate dhe mund të kontribuojnë për arsim më të mirë dhe proces më të mirë arsimor. Në fakt, në shumë universitete të huaja ajo është një praktikë kështu që unë nuk e shoh pse kjo do të jetë një problem për ne."

Debati publik mbi ndryshimet në Ligjin për Arsimin e Lartë

Deputetët diskutuan gjatë nëse i gjithë procesi i bërë për ndryshimet ligjore diskutimet parlamentare ishin mjaft përfshirëse për publikun apo nëse i kishin dëgjuar pikëpamjet e të gjitha palëve të interesuara. Qëndrimi i deputetëve nga shumica në pushtet ishte se në periudhën prej 3 muajsh përpara se ligji të hyjë në procedurën parlamentare në publik ishte diskutuar mjaftueshëm mbi propozimin. Një argument kyç në favor të këtij qëndrimi të deputetëve të shumicës ishte mungesa e përfaqësuesve të Plenumit të Profesorëve në diskutimin e organizuar nga Kryeministri në Kuvend, ku morrën pjesë zyrtarë të qeverisë,



rektori i Shën Qirili dhe Metodi dhe Iniciativa e Qytetarëve për mbështetje të diturisëi në arsimin e lartë. Kkundërshtarët kryesorë të ligjit dhe Plenumi studentor dhe i profesorëve nuk morën pjesë në diskutim.

Trajçe Dimkov, VMRO-DPMNE, seanca plenare nr. 31 leximi i dytë, 14/01/2015:

"Projekt-ligjet që duhej të rrisnin cilësinë e arsimit të lartë ishin të ndjekur disa muaj me debat gjatë të cilave janë pranuar 20 propozime konstruktive për universitetet dhe studentët. Në qoftë se dikush donte ta keqpërdor për të thënë se kishte debatim të mjaftueshëm, që nuk flitet mbi këtë temë, mua më duket se ata ishin të zbuluar. Edhe ata që donin me të vërtetë të debatonin dhe për ata që folën në interes të zgjidhjes së problemeve të caktuara në arsim atë edhe e bënë. Por, ata që thjesht pështyrë dhe nuk dëshiruan një të nesërme më të mirë për Maqedoninë dhe për arsimin, thjesht nuk janë më, përqaftuan luftën e demokracisë së rrugës dhe atë e bëjnë vazhdimisht çdo vit dhe unë nuk e di se deri ku do të arrijnë. "

Ballë për ballë me ta, deputetët e opozitës kanë deklaruar se nuk kishte asnjë ekspert dhe debat diskutues duke treguar për joorganizimin e një seance publike në Kuvend ku do të marrnin pjesë përfaqësues të universiteteve dhe plumeve studentore dhe profesorëve. Deputetët këtë e argumentuan me faktin se Kuvendi nuk iu përgjigj në kërkesën formale të profesorëve dhe studentëve për të marrë pjesë në një seancë të Komisionit të Arsimit dhe Shkencës, kur diskutohej për ndryshime ligjore.

Liljana Popovska, DOM, Seanca Plenare nr.36, 11.02.2015:

"Unë mendoj se gjëja e rëndësishme tani është të krijohet grup serioz punues që do të hartojë një ligj të ri për arsimin e lartë dhe në atë grup punës të përfshihen profesionistë të mirë dhe njerëz me eksperienc, por të mos harrojmë studentët. Sepse në lëkurën e tyre praktikisht zbatohet procesi arsimi dhe ata kanë vizionin e tyre e e cila edhe në këtë rast dhe në raste të tjera dëshmon të jetë shumë e saktë dhe shumë e rëndësishme për tu marrë në konsideratë. "

Roza Topuzovska Karevska, Seanca Plenare nr.36, 11.02.2015:

"Apo ishte e duhur të dilnin 10 mijë studentë dhe mbi 500 profesorë të nënshkruhen për të ardhur deri këtu. Ishte e mundur më thjesht, në një proces demokratik në Parlament, de facto për këtë edhe ekziston parlamenti, në qoftë se plenumi kërkon që



të marrë pjesë në një seancë të Komisionit kur debatohej për këtë ligj, duhej Parlamenti me dyer të hapura të presë profesorë të shquar për të paraqitur mendimet e tyre. Ndërsa ne deputetët, roli ynë në Parlament a është më përpara të dëgjojmë zërin e popullit, a nuk jemi ne përfaqësues të popullit, edhe ata 10 mijë studentë janë pjesë e popullit dhe ata profesorë të shquar janë pjesë e popullit. "

G.PËRFUNDIME:

- Asnjë deputet i vetëm nuk ka ndryshuar qëndrimin e tij/saj për shkak të agumenteve më të mira të paraqitura nga deputet të tjerë gjatë debatit. Në 36% të rasteve deputetët nuk kanë ndryshuar qëndrimin e tyre, por pranuan vlerën e argumenteve. Në 51% të diskutimeve nuk kanë ndryshuar qëndrimin e tyre, dhe as kanëjohur vlerën e argumenteve.
- Në debatin parlamentar për ndryshimin e Ligjit për arsim nuk është i regjistruar diskutim në të cilin nuk kishte asnjë shpjegim të qëndrimeve. Në shumicën e diskutimeve 49 % të deputetve kanë qëndrimet e tyre me dy ose më shumë argumente, dhe në 39% të diskutimeve me një argument. Në 12% të diskutimeve ka qenë arsyetim i pamjaftueshëm për t'u konsideruar argument i plotë.
- Në shumicën e diskutimeve ku janë identifikuar dyose më shumë argumente deputetët mbanin fjalim individual - 69%. Me thellimin e diskutimeve deputetët bëheshin më pak argumentues. Shumica e replikave janë të mbështetura me një argument (35%), dhe kontrareplikiat me shpjegim kryesisht të dobët (50%).
- Më shumë se gjysma e diskutimeve (53%) ishin në formën e replikave dhe kontrareplikave të fjalimeve individuale të deputetëve që sugjerojnë diskutim më të thellë dhe shkëmbimit të argumenteve mbi dispozitat e Ligjit për arsimin e lartë në krahasim me diskutimin për ndryshimet Kushtetutëse e cila u zhvillua në të njëjtën periudhë.
- Diskutime intensive për dispozita të veçanta ligjore kryesisht ndodhnin për shkak të deputeteve femra të cilat përbëjnë një pjesë dominuese (64%) të numrit të përgjithshëm të diskutimeve të paraqitura në debatin mbi ligjin.
- Në debatin mbi ligjin femrat kanë qenë më të argumentuara se meshkujt. Femrat përbënin shumicën e diskutimeve në më të përdorura dy ose më shumë argumente dhe diskutime të cilat përdoren argument.
- Në shumicën e rasteve deputetët në fjalimet e tyre shprehën respekt për pjesëmarrësit e tjerë në seancat. Në 21% të rasteve shprehën pajtueshmërinë të pjesshme që do të thotë se në shumicën e



diskutimeve folësit ishin neutral ose shprehnin respekt, por në një masë më të vogël vërehet mosrespektim ose drejtim i sulmeve personale dhe partiake mbi pjesëmarrësit e tjerë.

- Në shumicën e rasteve (51%) deputetët shprehën respekt ndaj argumenteve të paraqitura nga folësit e tjerë, dhe 22% kanë shprehur pajtueshmërinë të pjesshme. Në 22% e diskutimeve nuk kanë treguar ndonjë respekt ndaj argumenteve.
- Gjatë shpjegimit të qëndrimeve të tyre deputetët në 42% të diskutimeve kanë lidhur argumentet e tyre me të mirën e përbashkët ose pasojat e përbashkëta apo përfitimet për të gjithë qytetarët. Në 49% të rasteve folësit ishin neutral dmth nuk kanë lidhur qëndrimet e tyre me përfitime apo pasoja për ndonjë grup në shoqëri.
- Pjesa më e madhe e argumenteve të përmendura kanë të bëjnë me dispozitat e më mëposhtme të ligjit: Odnosvna qëllim të ndryshimeve të Ligjit për Arsimin e Lartë, Rradhitja e universiteteve dhe autonomia e tyre, futjen e provimit shtetëror, revista me faktor ndikimi, shtetasit e huaj mund të jenë dekan, si dhe nëse për ndryshimet kishte debat publik si dhe nëse janë ndëgjuar të gjitha palët..
- Deputetët sipas opsionit të tyre politik në mënyrë të vendosur i përfaqësojnë qëndrimet e tyre me çka gjatë përdorimit të argumenteve dhe mënyra në të cilën ato janë të paraqitura në seanca nuk demonstroi mundësi për pranimin eventual të argumenteve më të mira të folësve nga opsionet politike kundërshtarë dhe as mundësi për kompromis. Folësit në shumicën e rasteve i bazuan argumentet e tyre për përforsimin e qëndrimeve të tyre fillestare pa hyrë në krahasim cilësor të argumenteve të tyre kundërshtarë të folësve të tjerë.
- Gjatë procedurës parlamentare për ndryshimin e Ligjit për Arsimin e Lartë nuk është mbajtur diskutim publik sipas procedurave parlamentare.

Proekti "Kuvendi nën thjerrëz, përforsimi i debatit politik dhe i diskursit deliberativ " financohet nga Bashkimi Evropian.

Ky publikim është i punuar me asistencën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.